



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 2268141; 04 2268142

Nr. 144/7 Akti

Tiranë, më 25.04.2017

V E N D I M

Nr. 92, datë 25.04.2017

*"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nëpërmjet kërkesës së punonjësës *****, protokolluar me nr. 144 prot., datë 22.2.2017".*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit protokolluar pranë Komisionerit me nr. 144 prot., datë 22.2.2017, për disa pretendime të ngritura lidhur me procesin e konfirmimit të nëpunësit civil dhe transferimit të përkohshëm,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunëses *****, regjistruar me nr. 144 prot., datë 22.2.2017, ka marrë dijeni për disa shkelje të pretenduara në lidhje me mënyrën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të konfirmimit të nëpunësit civil dhe transferimit të përkohshëm. Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin nr. 144/1 prot., datë 28.2.2017 "Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa me nr. 144 prot., dt. 22.2.2017, për transferimin e përkohshëm në periudhën e provës dhe përfundimin e procedurave të konfirmimit si nëpunës civil", ka nisur verifikimin e këtij rasti.

Nga hetimi administrativ që është kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësja ***** është punësuar në detyrën "Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik", në Zyrën e Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik, në Degën Doganore Tiranë, në datën 29.10.2013, në një kohë kur ky institucion nuk ishte pjesë e shërbimit civil. Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është përfshirë në fushën e shërbimit civil. Ky rregullim materializohet edhe në Kodin e ri Doganor të miratuar me ligjin nr. 102/2014, të ndryshuar, ku parashikohet se punonjësit e administratës doganore, me përjashtim të punonjësve administrativë, janë nëpunës civil, (VKM nr. 142, dt. 12.3.2014, lidhja nr. 1, numër rendor 39 dhe ligji nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës

së *Shqipërisë*”, neni 13, pika 1). Ndodhur në këto rrethana dhe në kushtet kur, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, vendi i punës i punonjësës *****, përfshihej në fushën e veprimit të këtij ligji dhe ajo i plotësonte kërkesat e përgjithshme e të veçanta për t’u deklaruar si nëpunës civil, Departamenti i Administratës Publike, bazuar në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreun III, pika 2, të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil”, me aktin nr. 3304/590, datë 30.10.2014, ka deklaruar statusin e saj të punësimit në grupimin “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Zyrën e Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik, pranë Degës së Doganës Tiranë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Gjatë periudhës së provës, me urdhrin nr. 30960 prot., datë 19.12.2014 të drejtuesit të institucionit, rezulton se ajo është komanduar në një detyrë tjetër pranë Shoqërisë Konçesionare GFI Albania, për një afat të papërcaktuar, (në përmbajtjen e urdhrin përçaktohet se komandohet deri në një urdhër të dytë). Ndërkohë që punonjësja ende nuk ishte kthyer në vendin e mëparshëm të punës, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka nxjerrë urdhrin nr. 5242 prot., datë 27.2.2015, me të cilin ajo është transferuar përkohësisht në detyrën “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Zyrën e Turnit “A” (Terminali i Trageteve), në Degën Doganore Durrës. Më pas, për punonjësën në fjalë, është nxjerrë edhe një urdhër tjetër transferimi, e konkretisht urdhri nr. 2742 prot., datë 1.2.2017, me të cilin ajo është transferuar në detyrën “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Zyrën e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Rinas.

Nga sa analizuam më sipër, ndodhemi në rastin kur, kemi të bëjmë me punonjës të administratës doganore, për të cilat, disa elementë të marrëdhënies së punës rregullohen në bazë të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndërsa elementë të tjerë rregullohen në bazë të ligjit për nëpunësin civil. Punonjësja në fjalë, pretendon për parregullsi që kanë të bëjnë me administrimin e periudhës së provës. Për këtë arsye, bazuar në përcaktimet e pikës 8, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku parashikohet se, “**Periudha e provës, transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e ristrukturimit të institucionit, transferimi për arsye të paaftësisë shëndetësore dhe shmangies së konfliktit të interesave, pezullimi i marrëdhënies së punës dhe efektet e pezullimit rregullohen sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil**”, vlerësimi i rastit në fjalë, do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Afati i periudhës së provës, si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe deri në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Më konkretisht, neni 24, i ligjit përcakton se: “... Gjatë periudhës së provës, nëpunësi kryen ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s ... Në fund të periudhës së provës, institucioni, ku nëpunësi është i emëruar, vendos: a) konfirmimin e nëpunësit; b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit; c) moskonfirmimin e nëpunësit”. Ndërsa, në pikën 6, të kreut VI, të VKM së sipërcituar, përcaktohet se, vendimi në përfundim të periudhës së provës merret nga eprori direkt, bazuar në: “... a) rezultatin e testimi në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA; b) vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore”.

Nga verifikimi dhe trajtimi i tërësisë së rrethanave dhe dokumentacionit të administruar për këtë rast, konstatohet se, kemi të bëjmë me një punonjëse, të cilën, fillimi i efekteve të ligjit për nëpunësin civil e gjeti të punësuar në një pozicion të shërbimit civil, për një periudhë më pak se 1 vit e për këtë arsye, bazuar në përcaktimet e pikës 4, të nenit 67 të ligjit “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me marrëdhënien e saj të punës, zbatohen parashikimet e nenit 24, të këtij ligji. Kjo dispozitë parashikon se periudha e provës zgjat një vit dhe në këto kushte, në rastin konkret, për punonjësen në fjalë, ky afat ka filluar në datën 26.2.2014, (që është edhe data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar) dhe ka përfunduar në datën 26.2.2015. Aktualisht, megjithëse nga momenti i fillimit të afatit, kanë kaluar më shumë se dy vjet, rezulton se eprori direkt nuk e ka nxjerrë ende vendimin për mënyrën e përfundimit të periudhës së provës.

Nga këqyrja e dokumentacionit që përmban dosja e personelit të punonjësës *****, rezulton se ajo ka kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove të organizuar nga ASPA, në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore dhe në përfundim të tij, është pajisur me Çertifikatën nr: TMAD01-01-2015/03, të lëshuar nga ASPA, në datën 20.05.2015. Po kështu, në dosjen e personelit janë administruar vlerësimet e rezultateve në punë, të kryera në mënyrë periodike, ndër të cilët:

1) Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë, për periudhën 1.11.2013 - 31.12.2014, vlerësuar “kënaqshëm”; 2) Vlerësim për periudhën e provës, shkurt 2015 - qershor 2015, vlerësuar “mirë”, (nënshkrimi i zyrtarit raportues dt. 12.7.2015 dhe nënshkrimi i zyrtarit autorizues dt. 25.11.2015); 3) Vlerësim 6-mujor, për periudhën 1.7.2015 - 31.12.2015, vlerësuar “mirë”. 4) Vlerësim 6-mujor, për periudhën 1.1.2016 -30.6.2016, vlerësuar “shumë mirë”.

Ashtu si duket nga faktet e paraqitura më lart, vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, e cila zgjat një vit (nga dt. 26 shkurt 2014 deri në dt. 26 shkurt 2015), nuk është kryer për të gjithë vitin në mënyrë të pandërprerë, pasi për periudhën janar-shkurt 2015, duke mos respektuar kërkesat e ligjit, punonjësja është komanduar pranë Shoqërisë Konçesionare GFI Albania, (urdhër për komandim punonjësi, nr. 30960, datë 19.12.2014 i drejtuesit të institucionit). Në këto kushte, vlerësimin e munguar, për shkak të komandimit si më sipër, e plotëson vlerësimi i kryer për periudhën shkurt-qershor 2015, në të cilin, në mënyrë specifike është bërë shënimi: “Vlerësim për periudhën e provës”.

Konstatohet se, pas lëvizjes nga detyra me komandim, si dhe dy transferimeve të bëra më pas, punonjësja nuk është rikthyer në vendin e saj fillestar të punës, “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Degën Doganore Tiranë, që është edhe pozicioni i fituar sipas përcaktimeve të ligjit për nëpunësin civil.

Në kushte të tilla, në rastin e punonjësës *****, për të cilën afati i periudhës së provës ka përfunduar në muajin shkurt 2015, për të rregulluar situatën ligjore, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duhet të marrë masa për të finalizuar procesin e konfirmimit, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- a. Në kuptim të nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreut VI, pika 6, e në vijim të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, eprori direkt i pozicionit, “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Degën Doganore Tiranë (që është pozicionimi fillestar i punonjësës

*****, në administratën doganore dhe njëkohësisht edhe në shërbimin civil), të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të kreut VI, të pikës 7, të vendimit të sipërcituar.

- b. Vendimi i eprorit direkt, duhet t'i njoftohet nëpunëses ***** dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, i cili, në kuptim të kreut VI, pika 13, të aktit nënligjor të mësipërm, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të përmbyllë këtë proces, nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunëses, brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Pretendimin e paraqitur nga punonjësja, se proceset e komandimit në detyrë tjetër gjatë periudhës së provës dhe transferimet e mëpasme janë kryer në kundërshtim me ligjin, Komisioneri i vlerëson si të drejta. Në këtë përfundim arrihet pasi, komandimi apo transferimi i përkohshëm në një detyrë tjetër i punonjësës ***** gjatë periudhës së provës, i kryer me urdhrin nr. 30960 prot., datë 19.12.2014, të drejtuesit të institucionit, është kryer në kundërshtim me përcaktimet e kreut I, pika 3, të vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, i shfuqizuar me VKM nr. 125, datë 17.2.2016, por që ishte i zbatueshëm në momentin e kryerjes së këtij komandimi. Kjo dispozitë parashikon se, “Transferimi i përkohshëm nuk bëhet për nëpunësit civilë në periudhë prove ...”.

Ndryshimi i detyrës së nëpunësit civil në periudhë prove, nëpërmjet transferimit të përkohshëm, krijon vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që neni 24, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreu VI, i VKM nr. 243, datë 18.3.2015, kanë parashikuar për periudhën e provës, ashtu si dhe realisht ka ndodhur në rastin e punonjësës që po analizojmë.

Sa më sipër, dispozitat përkatëse që e rregullojnë periudhën e provës, nuk e lejojnë transferimin e nëpunësit civil gjatë kësaj periudhe.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga punonjësja ***** mbi parregullsitë e lejuara në procedurat e transferimeve që janë kryer më pas, në detyrën “Doganier klasifikim/ vlerësim/ kontroll fizik”, Zyra e Turnit A (Terminali i Trageteve), në Degën Doganore Durrës, i kryer me **urdhrin nr. 5242 prot., datë 27.2.2015** dhe në pozicionin aktual si “Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”, në Zyrën e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Rinas, i kryer me **urdhrin nr. 2742 prot., datë 1.2.2017**, konstatohet se këto transferime, të përkohshme në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, brenda administratës doganore, janë kryer pas përfundimit të kohës sa ka zgjatur periudha e provës.

Për këtë arsye, në këtë rast zbatohen përcaktimet e ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në pikën 3, të nenit 13, përcakton se “Përjashtimisht përcaktimeve të ligjit “Për nëpunësin civil”, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, pranimi në detyrë, emërimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, **transferimi i përkohshëm**, elementët specifikë të procedurës së dhënies së masave disiplinore të personelit të administratës doganore pjesë e shërbimit civil, **bëhet sipas parimeve dhe procedurave specifike të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij për këtë qëllim**”. Duhet thënë se në përfundim të afatit të transferimit punonjësja ***** nuk është rikthyer në pozicionin e mëparshëm, ashtu si parashikohet në shkronjën “a” dhe “c”, pika 7, e nenit 15, të Kodit Doganor. Në mënyrë të shprehur këto dispozita parashikojnë se:

(Pika a) *“Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje:*

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;*
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vet nëpunësit, deri në 3 muaj;*
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës”.*

(Pika c) *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte i transferuar”.*

Për arsyet e përmendura më sipër, në këtë rast për të rregulluar ligjshmërinë duhet të përmbyllet procesi i konfirmimit të nëpunëses ***** duke e kthyer në vendin fillestar të punës, si *“Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”*, në Degën Doganore Tiranë, pasi kanë përfunduar të gjitha afatet ligjore të transferimit nga ky pozicion.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të përmbyllë procesin e konfirmimit të nëpunëses ***** në përputhje me nenin 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe kreut VI, pika 6, e në vijim, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015 të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*:
- ✓ Eprori direkt i pozicionit *“Doganier klasifikim/vlerësim/kontroll fizik”*, në Zyrën e Klasifikimit/Vlerësimit/Kontrollit Fizik, në Degën Doganore Tiranë (*që është pozicioni i përhershëm i punonjëses ******, në administratën doganore dhe njëkohësisht edhe në shërbimin civil), të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të kreut VI, të pikës 7, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.
- ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t'i njoftohet nëpunëses ***** dhe njësisë përgjegjëse, DAP.
- ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të kreut VI, pika 13, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklaramit të statusit të nëpunëses ***** brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- ✓ Pas këtij veprimi, punonjësja të kthehet në pozicionin fillestar të punës, pasi ka përfunduar afati 6 mujor i transferimit.
- 2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe njësi e burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësja *****.
- 3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **15** ditë.
- 4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
- 5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA